



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 540/1 Prot

Tiranë, më 19/5/2016

Lënda: *Për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të Dhënave Personale.*

Drejtuar: **Z. Skënder VRIONI, Sekretar i Përgjithshëm**
KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 2416, datë 10.05.2016 do të gjeni bashkëlidhur një vlerësim për disa veprime që vetë autoritetet publike duhet të kryejnë në zbatimin e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për sa parashikon trajtimin e të dhënave personale të shtetasve subjekt verifikimi.

Me qëllim zbatimin në mënyrë të unifikuar të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, për t’ju ardhur në ndihmë autoriteteve publike të përcaktuara në ligjin 138/2015 si dhe çdo subjekti të interesuar, akti do të vendoset edhe në faqen web të institucionit me adresë: info@idp.al.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Besnik DERVISHI



KOMISIONERI

“Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vlerësuar në raport me ligjin nr. 9887/2008”

Ky vlerësim është kryer duke konsultuar ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (**më tej ligji nr. 138/2015**), Vendimin e Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015 “Për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrojnë Funksione Publike” (**më tej Vendimi nr. 17/2016**), Standardi i Formularit të Vetëdeklarimit për zbatimin e ligjit nr.138/2015 (**më tej formulari i vetëdeklarimit**) në raport me dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar (**më tej ligji nr. 9887/2008**).

Ligji nr.138/2015 (neni 8, pika 8) parashikon trajtimin e të dhënave personale të shtetasve subjekt verifikimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Nga ana tjetër, neni 16, pika 4 e vendos ligjin nr. 138/2015, në hierarkine e ligjeve që miratohen me shumicë të cilësuar dhe në rast konflikti midis normave, dispozitat e këtij ligji kanë përparësi.

Ligji nr.138/2015 në nenin 1, paragrafi i parë i tij përcakton specifikisht qëllimin, sipas të cilit është *garantimi i besimit të publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, sipas këtij ligji.*

Në interpretim të qëllimit specifik të këtij ligji, kërkohet të identifikohen persona të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerje të krimeve. Ky duket të jetë edhe rrethi i subjekteve të të dhënave personale të cilët përbëjnë interes të rëndësishëm për publikun.

Në konsideratë të gjithë sa më sipër, autoritetet publike (organet), të cilët në kuptim të nenit 5 të ligjit nr.138/2015 do të mbledhin, administrojnë, verifikojnë deklaratimet e subjekteve të këtij ligji si dhe do të bëjnë publike të dhënat e subjekteve, paraprakisht do të duhet të vlerësojnë përmbushjen e disa prej kërkesave të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Autoritetet publike të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr.138/2015, të cilët do të administrojnë të dhënat e subjekteve, detyrohen të bëjnë plotësimin e Njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit, në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 9887/2008, apo përditësimin e tij në përputhje me nenin 22 të këtij ligji.

Njoftimi bëhet për ato institucione që përpunojnë për herë të parë të dhëna, ndërsa për institucionet që kanë depozituar më parë Njoftimin duhet bërë përditësimi i tyre/i të dhënave, për përpunimin e ri që do të realizojnë në këtë rast.

Këto veprime duhet të ndodhin pa nisur përpunimi i të dhënave personale sipas ligjit nr. 138/2015, pasi çdo veprim ndryshe bie në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Publikimi është veprim që kryhet me të dhënat personale dhe si i tillë ai trajtohet si përpunim i të dhënave personale sipas ligjit nr. 9887/2008.

Autoritetet publike, në këtë përpunim të dhënash, duhet të vlerësojnë në përputhje me nenin 5/1/c të ligjit nr. 9887/2008, zbatimin e parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave që mbidhen në formularë, në përputhje me qëllimin specifik të ligjit nr.138/2015.

Neni 5/1/c

“Mbrojtja e të dhënave personale bazohet në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim”.

Në këtë këndvështrim, organet administruese të formularit të vetëdeklarimit duhet të vlerësojnë publikimin ose jo të disa të dhënave si p.sh. vendbanimi, amësia apo nr. ID.

Gjithashtu duhet vlerësuar në se publikimi i këtyre të dhënave i shërben **“interesit të rëndësishëm publik”** dhe “qëllimit” të përcaktuar në ligjin nr. 138/2015.

Vlerësohet që organet administruese të të dhënave, në përputhje me nenin 5/1/ ç të ligjit nr. 9887/2008, duhet të zbatojnë parimin e saktësisë dhe për këtë duhet që bërja publike e formularëve të vetëdeklarimit të paraprihet nga verifikimi i të dhënave.

Neni 5/1/ç

“Mbrojtja e të dhënave bazohet në saktësinë që të dhënat duhet të kenë dhe, kur është e nevojshme, duhet të përditësohen...”.

Në raport me ligjin nr.138/2015, vlerësohet që pas verifikimit të të dhënave, të bëhen publike vetëdeklarimet e personave që janë subjekt i qëllimit të këtij ligji sipas parashikimit të paragrafit të parë të nenit 1 të tij, por edhe për faktin se ky veprim i shërben interesit të rëndësishëm publik.

Ndërsa, për çdo subjekt tjetër, që pas verifikimit të të dhënave të vetëdeklaruar, nuk rezulton të përfshihet në kategorinë e personave të përcaktuar në nenin1/paragrafi i parë i ligjit nr.138/2015, mund të vlerësohet e panevojshme bërja publike e të dhënave personale.

Sa më sipër janë trajtuar disa nga veprimet kryesore gjatë përpunimit të të Dhënave Personale në këtë proces. Në çdo rast autoritetet publike, duhet të zbatojnë në tërësi parashikimet e ligjit 9887/2008 dhe akteve të Komisionerit në zbatim të tij.